



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 471/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxha kryesues, Ferit Osmani dhe Vllastimir Dimiq anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 14.12.2010, mori këtë:

VENDIM

HIDHET poshtë si e parregullt ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

ARSYETIMI

Më datë 12.12.2010 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik LVV, në të cilën pretendohet se aktivistet subjekti politik PDK me datë 12.12.2010 në shkollën fillore “Migjeni” si dhe në shkollën “Ismajl Qemajli”, Mitrovicë, në QV 1102B, QV 1102X dhe 1104B, janë rrethuar në masa tepër të madhja afër vendvotimeve dhe po tentonin të futeshin brenda, duke shfrytëzuar edhe mungesën e energjisë elektrike e cila po mungoi për më tepër se 4 orë. Parashtruesi i ankesës pretendon se deri në këto momente në orën 16:00 ende kanë qene të rrymës elektrike. Për këtë janë lajmëruar edhe organet e policisë dhe avokati i popullit. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Me rendesi është fakti, se parashtruesi i ankesës nuk e ka vërtetuar përmbajtjen e pretendimeve për arsye se formulari i ankesës se pranuar prej PZAP në datë 12.12.2010 nuk ka qene i firmosur prej personit të autorizuar të Lëvizjes Vetëvendosje .

Ne kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe nenit 3.6, pika (d) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP parashihet si vijon:

118.1 “PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet”;

3.6 "Te gjitha ankesat duhet te kenë se paku informacionet vijuese:

..... (d) vërtetimin nga pala ankuese lidhur me vërtetësinë e përmbajtjes së ankesës".

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi te gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e parregullt

Nga shkresat e lendes PZAP-i vlereson se ankesa është e parregullt për faktin se formulari i ankesës nuk përmbush kushtet e lartpërmendura, parashtuesi i ankesës nuk e ka nënshkruar ankesën e paraqitur duke e bere te pamundur qe te verifikohet personi i autorizuar për lëshimin e saj, për këtë arsye dhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 471/2010 më datën 14.12.2010

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

